



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 148, datë 22.12.2022

PËR
MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM (PBA) PËR VITET 2024-2026 DHE BUXHETIT VJETOR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligjit nr.68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e PBA Vendore 2023-2025”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Sektori i Analizës së Statistikave dhe Planifikimit Afatmesëm në Drejtorinë e Buxhetit, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për vitet 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor si më poshtë :

Aktivitetet për hartimin e PBA-së	Afatet për vitin 2023
Paraqet për shqyrtim dhe miratim në K.B, raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave në bazë të udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave për:	Deri me 31 Janar

-dy vitet para vitit buxhetor (2021 dhe 2022) -vitin buxhetor 2023 -tre vitet e ardhshme buxhetore (2024-2026)	
Miraton në K.B, raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave.	Deri me 1 Mars
Përgatit dhe paraqet në K.B, tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA-së në nivel Programi.	Mars
Miraton në K.B, tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA-së në nivel programi.	Brenda 15 Marsit
Pas miratimit të taveve përgatitore të shpenzimeve, miraton Udhëzimin e Brendshëm të përgatitjes së buxhetit të Nj.Q.V dhe e shpërndan tek secili Drejtues i Ekipit të Menaxhimit të Programit.(DEMP)	Deri në 20 Mars
DEMP,paraqesin kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit tek koordinatori i GMS.	Brenda muajit Prill
Dërgon projekt dokumentin e PBA-së, në M.F. (dy formularët Nr1. Dhe Nr.2 për parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve) të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar (IPF).	Deri në 1 Qershor
M.F analizon dhe dërgon zyrtarisht raportin me rekomandime mbi projekt-dokumentin e PBA-së për çdo Nj.Q.V	Deri në 20 Qershor
Kryetari i NjQV, organizon takime konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA.	Qershor
Këshilli i NjQV, mund të zhvillojë konsultime me publikun në fazën e parë dhe strategjike të përgatitjes së PBA-së si dhe në fazën e dytë, sipas kalendarit të përgatitjes së PBA-së.	Qershor
Dërgon për miratim në K.B, projekt dokumentin e parë të PBA të miratuar nga GMS për çdo Nj.Q.V, bashkë me raportin me rekomandime të M.F dhe Ekonomisë, i cili shqyrton dhe miraton këtë projekt dokument.	Deri në 30 Qershor
Publikimi i dokumentit të parë të PBA-së të miratuar.	Deri në 5 Korrik
Përgatit dhe miraton në K.B, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së, në nivel programi sipas udhëzimit plotësues të MF.	Deri në 20 Korrik
Kryetari, shpërndan Udhëzimin plotësues të përgatitjes se PBA-së, në Njësitë Shpenzuese.	Deri në 25 korrik
Përgatitet projekti i rishikuar i PBA-së.	Gusht
Publikimi i dokumentit të PBA-së të rishikuar.	Gusht
Organizimi i Seancave Dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit, ku mbahen proces-verbalet e takimeve së bashku me qëndrimet përkatëse të Nj.Q.V që bëhen pjesë e dokumentit të projektit të PBA-së.	Deri në 31 Gusht

Miraton në KB, dokumentin e PBA-së të rishikuar.	Shtator
Dërgimi në MF të dokumentit të PBA-së të rishikuar dhe të miratuar në K.B, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga MF në fazën e parë.	Deri në 15 Shtator
Përgatit projekt buxhetin vjetor, pas miratimit të PBA-së të rishikuar.	Deri 30 Shtator
Përgatit projektin e PBA-së përfundimtare dhe projekt buxhetin vjetor, duke reflektuar rekomandimet përfundimtare të MF.	Tetor
Paraqet projektin e PBA-së përfundimtare dhe buxhetin vjetor për shqyrtim dhe miratim në K.B të NjQV.	Deri në 30 Nëntor
Miratimi në K.B i PBA-së përfundimtare	25 Dhjetor
Publikimi i dokumentit të plotë të PBA-së, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tyre.	Deri në 31 Dhjetor
Dërgon dokumentin e plotë të PBA-së në M.F, 15 ditë pas miratimit në K.B dhe publikimit të PBA-së.	Deri 15 Janar

2. Ngarkohen të gjithë Drejtoritë, Ndërmarrjet dhe Institucionet në varësi të Bashkisë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.



KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 27.12.2022



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS**

Nr. 954/prot.
2

Durrës, më 29.12.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.148 datë 22.12.2022 “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (pba) për vitet 2024-2026 dhe buxhetit vjetor”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

